

**THE DETERMINATIVE FUNCTION WITH SPECIAL EMPHASIS ON
THE ARTICLE IN THE GERMAN LANGUAGE AND THE
EQUIVALENT FORMS IN THE ALBANIAN LANGUAGE
FUNKSIONI I CAKTUESORIT (DETERMINATIV) ME THEKS TË
VEÇANTË TË NYJËS (ARTIKEL) NË GJUHËN GJERMANE DHE
FORMAT EKVIVALENTE NË GJUHËN SHQIPE**

Muarem AJDARI¹

¹ *Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*} *Corresponding author e-mail: muarem.ajdari@unite.edu.mk*

Abstract

The use of the article in different languages is of great importance, especially when teaching and studying a foreign language. The use of the article, especially in the German language, presents a big problem for foreigners who learn or study the German language. This happens because when learning a foreign language, in most cases, the system of the native language serves in an analogous way. The article, in the grammars of different languages, is not treated as a separate word class or at least tends not to be treated as such.

The German language has a system of prefixing articles (definit *der, das die* and indefinit *ein, ein, eine*), while in the Albanian language there are the front articles *i, e, të, së* and back articles or suffixes of names depending on the case of the name. while in the Albanian language it is different, in fact there are front and back articles. The object of this paper is the article, respectively the definit and indefinit article as determinants of the name (Determinative), its use in the German language and the equivalent forms in the Albanian language. Other parts of the determinants can only be handled according to the given circumstances.

Key words: *Determinativ, Artikel, caktuesor, nyje, definit, indefinit, e shquar, e pashquar*

Abstrakt

Përdorimi i nyjës (*Artikel*) në gjuhë të ndryshme ka një rëndësi tepër të madhe, veçanërisht gjatë mësimdhënies dhe studimit të një gjuhe të huaj. Përdorimi i saj, në veçanti në gjuhën gjermane paraqet një problematikë mjaft të madhe për të huajt që mësojnë apo studiojnë gjuhën gjermane, e që në mënyrë analoge shërben sistemi i gjuhës amtare. Nyja, në gramatika të gjuhëve të ndryshme, nuk trajtohet si pjesë e veçantë e ligjëratës apo të paktën ka tendencë që të mos trajtohet si e tillë. Ajo trajtohet si një satelit i emrit (Engel, 2009: 312) apo si një fjalë që qëndron para një emri e që përshtatet me emrin për nga gjinia, rasa dhe numri (Helbig & Buscha, 2013).

Gjuha gjermane ka një sistem të paravendosjes së nyjave (të shquara *der, das, die* dhe të pashquara *ein, ein, eine*), ndërsa te gjuha shqipe ekzistojnë nyja të përparme *i, e, të, së* dhe të prapme ose mbaresa të emrave varësisht nga rasa e emrit. Objekt i këtij punimi është nyja, respektivisht nyja e shquarsisë dhe e pashquarsisë si caktuesor i emrit (*Determinative*). Në detaje do të trajtohet përdorimi i saj në gjuhën gjermane dhe format ekuivalente në gjuhën shqipe. Pjesët tjera të caktuesorëve mund të trajtohen vetëm sipas rrethanave të dhëna.

Key words: *Determinativ, Artikel, caktuesor, nyje, definit, indefinit, e shquar, e pashquar*.

Hyrje

Gjatë mësimit të një gjuhe të huaj, në të shumtën e rasteve në mënyrë analoge shërben sistemi i gjuhës amtare, në këtë rast sistemi i gjuhës shqipe. Gjuha gjermane ka një sistem të paravendosjes së nyjave (definit dhe indefinit), ndërsa te gjuha shqipe është ndryshe, në fakt ka nyja të përpame dhe të prapme (prapashtesa). Karakteristika kryesore e nyjës në gjuhën gjermane është se gjendet gjithmonë para një emri dhe përshtatet me të në gjini, rasë dhe numër, siç e definojnë atë autorët Helbig & Buscha (2013). Ndërsa Ulrich Engel (Engel, 2009), jep një sqarim të ngjashëm duke e konsideruar nyjën si fjalë që vendoset para një emri, por që nuk mund të shfaqet bashkë me gjinoren saksone.

Autori Shaban Demiraj, konsideron se nyja e bën të mundur krijimin e kuptimit gramatikor të shquarsisë e në kundërvënie me këtë përfitohet edhe kuptimi gramatikor i pashquarsisë (Demiraj, 1987: 298). Funkcioni kryesor i nyjës, si në gjuhën gjermane ashtu edhe në atë shqipe është ai i caktuesisë. Ajo është një fjalë funksionale që e shoqëron emrin. Nyja e ka për detyrë që të krijojë një sintagmë, kështu që në momentin kur një emri i shtohet nyja krijohet një sintagmë emërore, pra nga një kategori leksikore, si emër që vetëm emërton, kalon në një kategori sintaksore.

Salz

‘kripë’

*Kann ich bitte **das Salz** haben?*

‘A mund të ma jepni **kripën**.’

Në këtë punim do të trajtohet vetëm nyja (*Artikel*), respektivisht nyja e shquarsisë dhe e pashquarsisë (*der bestimmte und unbestimmte Artikel*), përdorimi i saj në gjuhën gjermane dhe format ekuivalente në gjuhën shqipe.

1. Rreth caktuesorëve në gjuhën gjermane

Caktuesorët janë fjalë, të cilat – derisa shfaqen si satelitë të emrit – nuk mund të shfaqen bashkë me gjinoren saksone (Engel, 2009: 312)

Annas beste Buch.

‘Libri më i bukur i Annas.’

**Das Annas beste Buch.*

Definicioni që (Engel, Deutsche Grammatik - Neubearbeitung, 2009) i jep nyjës, ka të bëjë më shumë me gjuhën gjermane dhe njëkohësisht duhet të theksojmë se përcaktimi i pjesëve të ligjëratës, i bërë nga ana e tij, është i lidhur me metodën e **distribucionit**, respektivisht i nënshtrohen të ashtuquajturës kornizë e distribucionit. Së pari merret rrethi **më i ngushtë**, që ka të bëjë me mbaresat e fleksionit, **rrethi i ngushtë**, që i përcakton fjalët brenda një togfjalëshi / sintagme, pastaj **rrethi i mesëm**, që ka të bëjë me togfjalëshat të tjerë / gjymtyra të fjalisë, dhe në fund **rrethi i gjerë**, që u dedikohet fjalive, respektivisht shprehjeve të tjera më gjerë në tekst.

Fjalët, siç e dimë, nuk paraqiten si të izoluara. Përkundrazi, ato, me strukturën e tyre lidhen mes veti për të formuar grupe fjalësh. Nëse këto grupe të fjalëve i shikojmë të izoluara, pa iu qasur mjedisit të tyre, atëherë ato i quajmë sintagma (frazë). Në një sintagmë, të gjitha fjalët janë të lidhura në bazë të varësisë (Engel, 2009: 14). Nëse nisemi nga rrethi më i ngushtë, që ka të bëjë me mbaresat e fleksionit, del se kur flasim për nyjat në fakt flasim për trajtën e shquar dhe të pashquar të emrit. Te caktuesorët, (Engel, 2009), i përfshin edhe: *Artikel, Possesiva, Demonstrativa/Definita, Indefinita, Negativa, Interrogativa*.

Në shumë gramatika nyja nuk paraqitet si pjesë e ligjëratës, por duke i paraqitur karakteristikat e saj do të mundohemi ta ndajmë atë nga pjesët tjera të ligjëratës.

1.1. Karakteristikat kryesore të nyjave në gjuhën gjermane sipas (Helbig & Buscha, 2013).

- Nyjat qëndrojnë gjithmonë para një emri:

Der Student lernt. ‘Studenti mëson.’

Der fleißige Student lernt. ‘Studenti i zellshëm mëson.’

- Me nyjën nuk mund të jetë e lidhur një nyjë tjetër në mënyrë koordinative.

**Das mein Kind lernt. Mein das Kind lernt.* ‘Fëmija im mëson.’

Kjo është e mundur:

- (1) kur ato janë në raporte varësie:

all(er) kombinohet me dëftorët (përveç me *derselbe*), një shquese dhe pronorët:

all diese Bücher

all die Bücher

alle meine Kinder

beide (kombinohet me dëftorët dhe pronorët):

mit diesen beiden Studenten

meine beiden Bücher

dieser (kombinohet me të gjithë pronorët):

diese seine Bücher

- (2) kur përdoren variantet e caktuesorëve *welch ein, solch ein, manch ein*:

solch ein Buch ‘një libër i tillë’

manch ein Buch ‘ndonjë libër’

welch ein Buch ‘çfarë libri’

- Nyja nuk mund ta ndërrojë pozitën e saj vetë në fjali, por së bashku me emrin të cilit i takon:

Der Student lernt für die Prüfung.

**Student der lernt für die Prüfung.*

- Nyjat përshtaten me emrin dhe mbiemrin eventual në raport me gjininë, rasën dhe numrin:

Der neue Student. Ein neuer Student.

Die neue Studentin. Eine neue Studentin.

Die neuen Studenten. Neue Studenten.

- Nyjat nuk e marrin pozicionin e mbiemrit, por e përcaktojnë tipin e lakimit të mbiemrit:

Der fleißige Student. ‘Studenti i zellshëm.’

Ein fleißiger Student. ‘Një student i zellshëm.’

2. Lakimi i nyjës së shquar në gjuhën gjermane dhe shqipe

2.1. Lakimi i nyjës së shquar në numrin njëjës

		Singular	Njëjës
		definitiver Artikel	nyja e shquar
Nominati v	<i>m</i>	der frohe Vogel der schöne Bleistift	<i>zogu i lumtur</i> <i>lapsi i bukur</i>
	<i>n</i>	das klare Sprechen	<i>të folurit e qartë</i>
	<i>f</i>	die frohe Mutter	<i>nëna e lumtur</i>
Akkus ativ	<i>m</i>	den frohen Vogel	<i>zogun e lumtur</i>
	<i>n</i>	das klare Sprechen	<i>të folurit e qartë</i>
	<i>f</i>	die frohe Mutter	<i>nënë e lumtur</i>
Dativ	<i>m</i>	dem frohen Vogel	<i>zogut të lumtur</i>
	<i>n</i>	dem klaren Sprechen	<i>të folurit të qartë</i>
	<i>f</i>	der frohen Mutter	<i>nënës së lumtur</i>

Geniti	<i>m</i>	des frohen Vogels	<i>i/e zogut të lumtur</i>
	<i>n</i>	des klaren Sprechens	<i>i/e të folurit të qartë</i>
	<i>f</i>	der frohen Mutter	<i>i/e nënës së lumtur</i>
Ablati	<i>m</i>	-/-	<i>zogut të lumtur</i>
	<i>n</i>	-/-	<i>të folurit të qartë</i>
	<i>f</i>	-/-	<i>nënës së lumtur</i>

- **Nyja e shquar për rasën emërore:**

Nyja për gjininë mashkullore te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-r** në fund *der* (mbiemri merr mbaresën **-e**), ndërsa te gjuha shqipe për tipin e lakimit të I-rë del me **-i lapsi** dhe për tipin e lakimit të II-të me **-u zogu**.

Nyja e gjinisë asnjane te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-s** në fund *das* (mbiemri merr mbaresën **-e**), ndërsa në gjuhën shqipe për tipin e lakimit të IV-t del me **-it të folurit**, me **-të të kuqtë**, me **-ët të verdhët**.

Nyja e gjinisë femërore te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-e** në fund *die* (mbiemri merr mbaresën **-e**), në gjuhën shqipe për tipin lakimit të III-të del me **-a nëna**.

- **Nyja e shquar për rasën kallëzore:**

Nyja për gjininë mashkullore te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-n** në fund *den* (mbiemri merr mbaresën **-en**), ndërsa te gjuha shqipe del për tipin e lakimit të I-rë me **-in lapsin** dhe për tipin e lakimit të dytë me **-un zogun**.

Nyja për gjininë asnjane te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-s** në fund *das* (mbiemri merr mbaresën **-e**), ndërsa në gjuhën shqipe për tipin e lakimit të IV-t del me **-it të folurit**, me **-të të kuqtë**, me **-ët të verdhët**.

Nyja për gjininë femërore te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-e** në fund *die* (mbiemri merr mbaresën **-e**), në gjuhën shqipe për tipin lakimit të III-të del me **-ën nënën**.

- **Nyja e shquar për rasën dhanore:**

Nyja për gjininë mashkullore te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-m** në fund *dem* (mbiemri merr mbaresën **-en**), ndërsa te gjuha shqipe për tipin e lakimit të I-rë del me **-it lapsit** dhe për tipin e lakimit të dytë me **-ut zogut**.

Nyja për gjininë asnjane te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-m** në fund *dem* (mbiemri merr mbaresën **-en**), ndërsa në gjuhën shqipe për tipin e lakimit të IV-t del me **-it të folurit**.

Nyja për gjininë femërore te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-r** në fund *der*, në gjuhën shqipe për tipin e lakimit të III-të del me **-ës nënës**.

- **Nyja e shquar për rasën gjinore:**

Nyja për gjininë mashkullore te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-s** në fund *des* (mbiemri merr mbaresën **-en**, ndërsa emrit i shtohet një **-s**), ndërsa te gjuha shqipe për tipin e lakimit të I-rë del me **-it** duke ia shtuar përpara nyjën e përparme që tregon pronë **-i/e lapsit** dhe për tipin e lakimit të dytë me **-ut i/e zogut**.

Nyja për gjininë asnjane te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-s** në fund *das* (mbiemri merr mbaresën **-en**, ndërsa emrit i shtohet një **-s**), ndërsa në gjuhën shqipe për tipin e lakimit të IV-t del me **-it** duke ia shtuar përpara nyjën e përparme që tregon pronë **-i/e të folurit**, me **-it i/e të kuqtit**, me **-ës i/e të verdhës**.

Nyja për gjininë femërore te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën **-r** në fund *der* (mbiemri merr mbaresën **-en**), në gjuhën shqipe për tipin lakimit të III-të del me **-ës** duke ia shtuar përpara nyjën e përparme që tregon pronë **-i/e nënës**.

- **Nyja e shquar për rasën dhanore (Ablativ)**

Gjatë lakimit të emrave në gjuhën shqipe udhëhiqemi me mbaresat e dhanores. Kjo vlen edhe për lakimin e nyjës së shquar në shumës si dhe nyjës së pashquar në njëjës dhe në shumës.

2.2. Lakimi i nyjës së shquar në numrin shumës

Plural		Shumës	
definitiv Artikel		<i>nyja e shquar</i>	
Nominativ	<i>m</i>	die frohen Vögel die schönen Bleistifte die frohen Schüler	<i>zogjtë e lumtur</i> <i>lapsat e bukur</i> <i>nxënësit e lumtur</i>
	<i>n</i>	die angenehmen Häuser die garantierten Rechte	<i>shtëpitë e këndshme</i> <i>të drejtat e garantuara</i>
	<i>f</i>	die frohen Mütter	<i>nënat e lumtura</i>
Akkusativ	<i>m</i>	die frohen Vögel	<i>zogjtë e lumtur</i>
	<i>n</i>	die angenehmen Häuser die garantierten Rechte	<i>shtëpitë e këndshme</i> <i>të drejtat e garantuara</i>
	<i>f</i>	die frohen Mütter	<i>nënat e lumtura</i>
Dativ	<i>m</i>	den frohen Vögeln	<i>zogjve të lumtur</i>
	<i>n</i>	den angenehmen Häusern den garantierten Rechten	<i>shtëpive të këndshme</i> <i>të drejtave të garantuara</i>
	<i>f</i>	den frohen Müttern	<i>nënave të lumtura</i>
Genitiv	<i>m</i>	der frohen Vögel	<i>i/e zogjve të lumtur</i>
	<i>n</i>	der angenehmen Häuser der garantierten Rechte	<i>i/e shtëpive të këndshme</i> <i>i/e të drejtave të garantuara</i>
	<i>f</i>	der frohen Mütter	<i>i/e nënave të lumtura</i>
Ablativ	<i>m</i>	-/-	<i>zogjve të lumtur</i>
	<i>n</i>	-/-	<i>shtëpive të këndshme</i> <i>të drejtave të garantuara</i>
	<i>f</i>	-/-	<i>nënave të lumtura</i>

- **Nyja e shquar për rasën emërore:**

Nyja për shumësin për të tri gjinitë te gjuha gjermane është *die* (mbiemri merr mbaresën **-en**), ndërsa te gjuha shqipe për tipin e lakimit të I-rë del me **-t lapsat / -it nxënësit**, për tipin e lakimit të II-të me **-të zogjtë**, për tipin e lakimit të III-të **-të shtëpitë / -t nënat**.

- **Nyja e shquar për rasën kallëzore:**

Nyja për shumësin për të tri gjinitë është *die* (mbiemri merr mbaresën **-en**), ndërsa te gjuha shqipe për tipin e lakimit të I-rë del me **-t lapsat / -it nxënësit**, për tipin e lakimit të II-të me **-të zogjtë**, për tipin e lakimit të III-të **-të shtëpitë / -t nënat**.

- **Nyja e shquar për rasën dhanore:**

Nyja për shumësin për të tri gjinitë është *den* (mbiemri merr mbaresën **-en**), ndërsa te gjuha shqipe për të gjithë tipat e lakimit del me **-ve**.

- **Nyja e shquar për rasën gjinore:**

Nyja për shumësin për të tri gjinitë është *den* (mbiemri merr mbaresën **-en**), ndërsa te gjuha shqipe për të gjithë tipat e lakimit del me **-ve** duke ia shtuar përpara nyjën e përparme që tregon pronë **-i/e**.

2.3. Lakimi i nyjës së pashquar në numrin njëjës

		Singular	Njëjës
		indefiniter Artikel	nyja e pashquar
Nominativ	M	ein froher Vogel	(një) zog i lumtur
	N	ein klares Sprechen	(një) të folur e qartë / një e folur e qartë
	F	eine frohe Mutter	(një) nënë e lumtur
Akkusativ	M	einen frohen Vogel	(një) zog të lumtur
	N	ein klares Sprechen	(një) të folur të qartë
	F	eine frohe Mutter	(një) nënë të lumtur
Dativ	M	einem frohen Vogel	(një) zogu të lumtur
	N	einem klaren Sprechen	(një) të foluri të qartë
	F	einer frohen Mutter	(një) nënë të lumtur
Genitiv	M	eines frohen Vogels	i/e (një) zogu të lumtur
	N	eines klaren Sprechens	i/e (një) të foluri të qartë
	F	einer frohen Mutter	i/e (një) nënë të lumtur
Ablativ	M	-/-	(një) zogu të lumtur
	N	-/-	(një) të foluri të qartë
	F	-/-	(një) nënë të lumtur

- **Nyja e pashquar për rasën emërore:**

Nyja e pashquar për gjininë mashkullore te gjuha gjermane është *ein*, mirëpo, meqenëse forma e shquar karakterizohet me shkronjën *-r*, kur emri përdoret në trajtën e pashquar kjo do të shprehet te mbiemri (*-er*), ndërsa te gjuha shqipe del pa mbaresë, por me nyjën e pashquar *një* (*një*) *laps*.

Nyja e pashquar për gjininë asnjansore te gjuha gjermane është *ein*. Edhe këtu vlen njëjtë si te gjinia mashkullore. Trajta e shquar e gjinisë asnjansore në emërore karakterizohet me shkronjën *-s* në fund, ndërsa gjatë përdorimit të trajtës së pashquar ajo do të shprehet te mbiemri (*-es*), ndërsa në gjuhën shqipe del pa mbaresë, por eventualisht me nyjën e pashquar *një* (*një*) *të qeshur*.

Nyja e pashquar për gjininë femërore te gjuha gjermane është *eine*, e cila karakterizohet me shkronjën *-e* në fund, pra edhe te nyja e pashquar edhe te mbiemri, në gjuhën shqipe del pa mbaresë dhe eventualisht me nyjën *një* (*një*) *nënë*.

- **Nyja e pashquar për rasën kallëzore:**

Nyja e pashquar për gjininë mashkullore te gjuha gjermane është *einen*, karakterizohet me *-en* në fund (*einen*), por edhe mbiemri merr mbaresën *-en*, ndërsa te gjuha shqipe del për tipin e lakimit të I-rë pa mbaresë *një* (*një*) *laps* dhe për tipin e lakimit të dytë gjithashtu pa mbaresë *një* (*një*) *zog*.

Nyja e pashquar për gjininë asnjansore te gjuha gjermane është e njëjtë sikur në emërore, e që në fakt edhe për gjininë mashkullore është *ein*, dhe kjo gjë paraqet problem gjatë të mësimit dhe studimit të gjuhës gjermane. Mirëpo duke e ditur faktin se gjinia asnjansore në të shquar karakterizohet me shkronjën *-s* në fund (*das*), kur përdoret nyja e pashquar duhet të kihet kujdes që kjo karakteristikë e formës së shquar të shprehet te mbiemri (*-es*). Në gjuhën shqipe del pa mbaresë *një* (*një*) *të folur*.

Nyja e pashquar për gjininë femërore te gjuha gjermane karakterizohet me shkronjën *-e* në fund të nyjës dhe me një *-e* si mbaresë e mbiemrit. Në gjuhën shqipe del pa mbaresë *një* (*një*) *nënë*.

- **Nyja e pashquar për rasën dhanore:**

Nyja e pashquar për gjininë mashkullore karakterizohet me mbaresën **-em** në fund (*einem*), ndërsa mbiemri që pason merr mbaresën **-en**. Te gjuha shqipe del për tipin e lakimit të I-rë me **-i** (*një*) *lapsi* dhe për tipin e lakimit të dytë me **-u** (*një*) *zogu*.

Nyja e pashquar për gjininë asnjane karakterizohet me **-em** në fund (*einem*), njëkohësisht mbiemri merr mbaresën **-en**, ndërsa në gjuhën shqipe del me **-i** (*një*) *të foluri*.

Nyja për gjininë femërore karakterizohet me **-er** në fund, mbiemri që pason merr mbaresën **-en**, ndërsa në gjuhën shqipe del **-e** (*një*) *nëne*.

- **Nyja e pashquar për rasën gjinore:**

Nyja e pashquar për gjininë mashkullore karakterizohet me mbaresën **-es** në fund (*eines*) dhe mbiemri merr mbaresën **-en**, ndërsa te gjuha shqipe del për tipin e lakimit të I-rë me **-i** duke ia shtuar përpara njëjën e përparme që tregon pronë **-i/e** (*një*) *lapsi* dhe për tipin e lakimit të dytë me **-u i/e** (*një*) *zogu*.

Nyja e pashquar për gjininë asnjane karakterizohet me **-es** në fund (*eines*), njëkohësisht mbiemri që mund të pasojë merr **-en**, ndërsa në gjuhën shqipe del me **-i** duke ia shtuar përpara njëjën e përparme që tregon pronë **-i/e** (*një*) *të qeshuri*.

Nyja e pashquar për gjininë femërore karakterizohet me shkronjën **-r** në fund, në gjuhën shqipe del me **-e** duke ia shtuar përpara njëjën e përparme që tregon pronë **-i/e** (*një*) *nëne*.

2.4. Trajta e pashquar në numrin shumës

		Plural	Shumës
		indefiniter Artikel	nyja e pashquar
Nominativ	<i>m</i>	frohe Vögel	zogj të lumtur
	<i>n</i>	schöne Häuser	shtëpi të këndshme
	<i>f</i>	frohe Mütter	nëna të lumtura
Akkusativ	<i>m</i>	frohe Vögel	zogj të lumtur
	<i>n</i>	schöne Häuser	shtëpi të këndshme
	<i>f</i>	frohe Mütter	nëna të lumtura
Dativ	<i>m</i>	frohen Vögeln	zogjve të lumtur
	<i>n</i>	schönen Häusern	shtëpive të këndshme
	<i>f</i>	frohen Mütter	nënave të lumtura
Genitiv	<i>m</i>	frohen Vögel	i/e zogjve të lumtur
	<i>n</i>	schönen Häuser	i/e shtëpive të këndshme
	<i>f</i>	frohen Mütter	i/e nënave të lumtura
Ablativ	<i>m</i>	-/-	zogjve të lumtur
	<i>n</i>	-/-	shtëpive të këndshme
	<i>f</i>	-/-	nënave të lumtura

Emrat në trajtën e pashuar të numrit shumës në gjuhën gjermane nuk marrin nyje përpara.

- **Rasa emërore dhe kallëzore:**

Për rasën emërore dhe kallëzore karakteristike është te lakimi i mbiemrave se marrin mbaresën **-e**. Te lakimi i emrave të gjuhës shqipe emrat nuk marrin mbaresa, por vetëm mbiemri përshtatet me emrin.

- **Rasa dhanore:**

Për rasën dhanore të gjuhës gjermane, emrat e gjinisë mashkullore dhe asnjane marrin mbaresën **-n** dhe mbiemrat marrin mbaresat **-en**, ndërsa të gjinisë femërore nuk pësojnë ndryshim. Te gjuha shqipe emrat e të tri gjinive marrin mbaresën **-ve**.

- **Rasa gjinore:**

Në rasën gjinore, emrat në gjuhën gjermane nuk pësojnë ndryshime, por mbiemrat para tyre marrin mbaresat **-en**. Në gjuhën shqipe emrat marrin mbaresat **-ve**, si dhe u shtohet nyja e përparme që tregon pronësi **-i/e**.

Përfundim

Nyjat e shquara dhe të pashquara në gjuhën gjermane janë të paravendosura, (der, das, die, ein, ein, eine). Në gjuhën shqipe paraqiten të paravendosura (i, e, të) dhe të prapavendosura (sufikse për rasa të caktuara). Lakimi i nyjës në gjuhën gjermane bëhet në të katër rasat: Nominativ, Akkusativ, Dativ dhe Genitiv. Ajo e përcjell emrin dhe njëkohësisht i bart karakteristikat e emrit lidhur me gjininë, numrin dhe rasën. Lakimi i mbiemrave në gjuhën gjermane dallon varësisht se a përdoret nyja e shquar (definitiv Artikel), apo nyja e pashquar (indefinitiv Artikel), apo edhe pa nyje.

Në gjuhën shqipe nyjat, si ekuivalente të nyjave të gjuhës gjermane: *der, das, die*, dalin të paravendosura vetëm në rasën gjinore, te rasat tjera dalin të prapavendosura. Ajo që duhet të kihet parasysh është nyja që paraqitet para mbiemrit, edhe atë për trajtën e shquar në emërore *i* për gjininë mashkullore, *të/e* për gjininë asnjënjë dhe *e* për gjininë femërore, në kallëzore del *e* për të tri gjinitë, ndërsa për dhanoren, gjinoren dhe rrjedhoren për gjininë mashkullore dhe asnjënjë del nyja *të*, ndërsa për gjininë femërore nyja *së*. Për trajtën e shquar në shumës paraqitet nyja *e* para mbiemrit për emëroren dhe kallëzoren për të tri gjinitë, ndërsa për dhanoren, kallëzoren dhe rrjedhoren paraqitet nyja *të*.

Për trajtën e pashquar të nyjave duhet të theksohet se vetëm në njëjës e emërores dallohet nyja para mbiemrit për gjininë mashkullore *i*, për gjininë asnjënjë dhe femërore *e*, ndërsa në rasat kallëzore, dhanore, gjinore dhe rrjedhore marrin nyjën *të*. Në shumësin e të pashquarës mbiemrat marrin nyjën *të* në të gjitha rasat dhe për të tri gjinitë e emrit.

Referencat

- Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, S., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., & Likaj, E. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Vëll. i 1). Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë.
- Buchholz, O., & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie.
- Bußmann, H. (2002). *Lexikon der Sprachwissenschaft*. Stuttgart: Kröner.
- Çeliku, M., Domi, M., Floqi, S., Mansaku, S., Përnaska, R., Prifti, S., & Totoni, M. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II* (Vëll. i 2). Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë.
- Demiraj, S. (1987). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
- Duden. (2003). *Deutsches Universalwörterbuch* (bot. i 5). (Dudenredaktion, Re.) Mannheim: Dudenverlag.
- Duden. (2006). *Die Grammatik* (bot. i 7, Vëll. i 4). Mannheim: Bibliographisches Institut & F.A. Brockhaus AG Mannheim.
- Eisenberg, P. (2004). *Grundriß der deutschen Grammatik* (Vëll. i 2). Stuttgart: Metzler.
- Engel, U. (1992). Der Satz und seine Bausteine. Në V. Agel, R. Hessky, V. Agel, & R. Hessky (Red.), *Offene Fragen - offene Antworten in der Sprachgermanistik* (fv. 53-76). Tübingen: Max Niemeyer Verlag.
- Engel, U. (1994). *Syntax der deutschen Gegenwartsprache*. Berlin: Schmidt.
- Engel, U. (1996). *Deutsche Grammatik* (bot. i 3., korrigierte Auflage). Heidelberg: Julius Groos Verlag.
- Engel, U. (2009). *Deutsche Grammatik - Neubearbeitung* (bot. i 2). München: IUDICIUM Verlag.
- Engel, U., & Schumacher, H. (2003). *Kleines Valenzlexikon deutscher Verben*. Mannheim: Institut für deutsche Sprache.
- Eroms, H. (2000). *Syntax der deutschen Sprache*. Berlin/New York: de Gruyter.
- Hahn, J. (1854). *Albanesische Studien*. Jena: Mauke.
- Helbig, G., & Buscha, J. (2013). *Deutsche Grammatik*. München: Klett-Langenscheidt.
- Heringer, H.-J. (1996). *Deutsche Syntax dependenziell*. Tübingen: Stauffenburg.
- Rein, K. (1983). *Einführung in die kontrastive Linguistik*. Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft.
- Schulz, D., & Griesbach, H. (1970). *Grammatik der deutschen Sprache*. München: Max Hueber Verlag.
- Simoni, Z. (1978). *Fjalor gjermanisht - shqip*. Tiranë: 8 Nëntori.
- Sternemann, R. (1983). *Einführung in die kontrastive Linguistik*. Leipzig: Veb.
- Zifonun, G., Hoffmann, L., & Strecker, B. (1997). *Grammatik der deutschen Sprache*. Berlin: de Gruyter.